



VENDIM

Nr. 79, Datë 07.06.2016

**MBI
MIRATIMIN E “KONTRATËS PËR SIGURIMIN E SHËRBIMEVE
NDIHMËSE DHE TË BALANCIMIT TË SISTEMIT ELEKTRO-
ENERGJITIK PËR PERIUDHËN KOHORE 01.01.2016 – 30.06.2016”
MIDIS OST SH.A. DHE KESH SH.A.**

Në mbështetje të neneve 16; 20 gërma “h” dhe 110 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; Kapitullit V, të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 68, datë 23.06.2008, të ndryshuar dhe VKM-së nr. 244, datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e tij të datës 07.06.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtoritë Teknike në lidhje me “Kontratën për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektro – energjitik për periudhën kohore 01.01.2016 – 30.06.2016 midis OST sh.a. dhe KESH sh.a”,

Konstatohet se :

- Palët e kësaj kontrate janë subjekte juridike të legjitimuara për nënshkrimin e kontratës “për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektro – energjitik për periudhën kohore 01.01.2016 – 30.06.2016” midis OST sh.a. dhe KESH sh.a” duke patur parasysh që licenca e shoqërisë OST sh.a., në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike është rinovuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 24, datë 26.03.2009 dhe licenca e shoqërisë KESH sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike është rinovuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 23, datë 25.03.2009.
- Sipas parashikimeve të Kapitullit “V”, të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 68, datë 23.06.2008, të ndryshuar, marrëdhënia midis KESH sh.a. dhe OST sh.a, rezulton të jetë marrëdhënie e rregulluar.

- Duke qënë se “Kontrata për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektro – energjistik midis OST sh.a. dhe KESH sh.a” rregullon periudhën 01.01.2016 - 30.06.2016, vlen të sqarohet se baza ligjore në të cilën ajo gjen mbështetje për periudhën 01.01.2016 – 30.03.2016, janë nenet 51, gërmat “b” dhe “d”; 56 gërma “F” të Ligjit Nr 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike"; parashikimet e Modelit të Tregut të Energjisë miratuar me VKM nr. 338 datë 19.03.2008, i ndryshuar dhe Rregullat e Tregut të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.06.2008, të ndryshuar.

Që nga momenti i hyrjes në fuqi të VKM nr. 244, datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, përcaktimet e Modelit të Tregut të Energjisë të miratuar me VKM nr. 338 datë 19.03.2008, i ndryshuar, nuk zbatohen më, duke vendosur kështu detyrimin për të miratuar këtë kontratë sipas VKM së sipërcituar.

VKM nr. 244, datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, nuk ka fuqi prapavepruese dhe si e tillë nuk mund të rregullojë të gjithë periudhën e shkuar në të cilën ka shtrirë efektet kontrata për shit-blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit. Efektet fillojnë nga data e hyrjes në fuqi të kësaj VKM-je.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë kontratën “për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektro – energjistik midis OST sh.a. dhe KESH sh.a”, për periudhën kohore 01.01.2016 - 30.06.2016.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë KESH sh.a dhe OST sh.a për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI